

-41-

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI KOMBETARE I UJIT**  
**KESHILLI BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE**

---

**VENDIM**

Nr 6 Dt. 05.09.2012

**MIRATIMIN NE PARIM**

**“MBI PERDORIMIN E BURIMIT UJOR PERROI GJURES SE MAZHICES,  
KOMUNA MAQELLARE, DIBER  
PER PRODHIM TE ENERGJISE ELEKTRIKE NGA  
SUBJEKTI “ SUFA 1 ” sh.p.k.  
HEC GJURE ”.**

Bazuar ne kerkesen e pa kerkuar te bere nga subjekti “ Sufa 1 ” sh.p.k. per perdorimin e burimit uJOR Perroi Gjures se Mazhices, Komuna Maqellar, Diber, per prodhim energjie elektrike nen 15 MW, sipas dokumentacionit qe disponon K.B.U. Drin- Bune dhe udhezimit te Perbashket ne mes te M.M.P.AU. me M.E.T.E., rezulton se propozimi i mesiperm nuk ka te beje me projekte per te cilat ka filluar apo eshte shpallur procedura e perzgjedhjes.

Sipas dokumentacionit te paraqitur nga subjekti i mesiperme vepra e marrjes te ujit, do te ndertohet ne perroin e Gjures se Mazhices , ne kuoten + 695 m. Ndertesa e centralit do ndertohet , ne kuoten + 403 m. Prurja mesatare ne vepren e marrjes eshte  $Q = 0.15 \text{ m}^3/\text{sek}$ . Subjekti kerkon te shfrytetoje nje prurje  $Q = 0.18 \text{ m}^3/\text{sek}$ .


Subjekti nuk do pengoje perdorimin e ujit per nevojat e komunitetit.

Ky informacion jepet nga K.B.U. Drin-Bune, bazuar ne nenet 4, 5, 9 dhe 23 te ligjit nr. 9663 dt. 18.12.2006 “ PER KONCESIONET” dhe ne zbatim te tij te germes b, pika 3, kreu IV, i V.K.M. nr. 87 dt. 16.01.2008, “Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 27 dt. 19.01.2007 te K.M. “Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies se koncesioneve”, te ndryshuar, per plotesim dokumentacioni.

**PER KESHILLIN E BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE**

**Sekretari**

**Muhamet MUÇA**



**Kryetare**

**Voltana ADEMI**



MORA NJE KOPJE